



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORATI

PROGRAMI I TRANSPARENCËS  
PËR  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

**I. HYRJE**

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është përgatitur Programi i Transparencës për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI) si dhe në kuadër të VKM nr. 781, dt 26.12.2018 “Për garantimin e transparencës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (këtej e tutje UMT), ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. UMT-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së UMT-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.umed.edu.al](http://www.umed.edu.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të Programit të Transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet të UMT-së. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e UMT-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, i cili duhet të jetë i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale që posedohen nga UMT-ja.

Në rubrikat e faqes zyrtare të internetit të UMT-së, pasqyrohen edhe informacione të cilat karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale, për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve dhe të të dhënave, etj.

*Alba Lako*  
*Stani*